



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1045/2 Prot.

Tiranë, më 19 . 10 . 2023

V E N D I M

Nr. 205 , datë 19 . 10 . 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 188 Regj., datë 25.09.2023¹, të shtetases Xh. H, kundër Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Shijak, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “çdo shkak tjetër²” dhe të “shtatzënisë³”

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, Xh. H, në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, është shprehur se:
“Kam që nga viti 2020 që punoj me kontrata pune provizore në shkolla të ndryshme të ZVAP Shijak, deri në muajin dhjetor 2022, kur kam marrë raport për leje lindje, i cili përfundon në muajin nëntor 2023. Kam mbaruar studimet në degën Matematikë-Fizikë, me profil minor në Informatikë.

Fillimisht kam fituar një vend pune, për vitin shkollor 2020-2021, me anë të konkurimit në portal, me kontratë provizore në shkollën 9-vjeçare “Petrit Llaftiu”, Shijak, me normë 20 orë (Fizikë + TIK) në javë, me orë të ndara në 3 (tri) shkolla.

¹ Plotësuar nga ankuesja nëpërmjet e-mailit datë 05.10.2023.

² Ankuesja ka shpjeguar faktin se babai i bashkëshortit është i ndjekur politik, pra ish-i persekutuar nga regjimi komunist dhe si dokument ka depozituar shkresën me nr. 448 prot., datë 03.11.2022 “Vërtetim për dhënie statusi të A. M. H”, lëshuar nga Instituti i Integritetit të Ish të Përndjekurve Politikë.

³ Ankuesja ka shpjeguar me këtë shkak lejen e lindjes si rezultat i shtatzënisë.

⁴ Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

Edhe në vitin pasardhës 2021-2022, fitova një vend pune, gjatë konkurimit në portal, një kontratë provizore me të njëjtën shkollë, me normë 22 orë në javë (Fizikë + TIK), të ndara në dy shkolla, me arsyetimin se nuk kemi orë fizike të mjaftueshme. Ndërkohë që më është thënë se, kemi zgjedhur vendim provizor për shkak se nuk dihet se si do të jenë orët vitin pasardhës, ndërkohë që orët kishin vazhdimësi në vitet pasardhëse dhe nuk cenoheshin as nga numri i nxënësve, dhe as nga mosplotësimi i një mësuesi tjetër me normë që mund të ishte me kontratë definitive në këto dy shkolla.

Në vitin shkollor 2022-2023, pas konkurimit në portal, arrita të fitoj një vend pune, përsëri me vendim provizor në shkollën 9-vjeçare “Rilindja” Sallmone, ku norma (Fizikë + TIK) plotësohet në këtë mënyrë: 13 orë në shkollën “Rilindja” Sallmone, dhe 7 orë në shkollën “Muharrem Plaku”, Rreth.

Pas ankesës time për t’u emëruar si mësuese definitive, më është deklaruar nga ZVAP Shijak, se nuk mund të emërojmë si definitive pasi nuk ka orë të mjaftueshme për lëndën e fizikës, ndërkohë që ky vend në shkollën “Rilindja” është shapllur vakant në muajin shtator 2023, pasi unë jam ende me leje lindje deri në nëntor 2023. Mendoj se ZVAP Shijak ka bërë këtë lëvizje me qëllim që të punësojë njerëz të njohur të Drejtoreshëa në kurrizim tim dhe të familjes time, duke shkelur ligjet dhe udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit, në lidhje me portalin “Mësues për Shqipërinë”. Nisur nga këto, mendoj se më takonte me të drejtë vendimi si mësuese definitive në këto shkolla ku kam dhënë mësim, por tani së fundmi kemi kuptuar se, po diskriminohemi si familje për shkak se babai i ndjerë i bashkëshortit tim, ka qenë i përndjekur politik. Tani në këtë moment unë jam pa punë dhe vendi provizor që kam pasur në vitin 2022-2023, është nxjerrë në portal si vend vakant në muajin shtator 2023, ndërkohë që mua leja e lindjes 1-vjeçare më mbaron në fund të nëntorit 2023.”

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit nga ana e ZVAP Shijak, për shkaqet e pretenduara.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues dhe lidhjen shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, në raport me subjektet nga të cilët pretendon se diskriminohet, apo me të drejtën ligjore të saj.

- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it të datës 04.10.2023, KMD, i ka kërkuar subjektit ankues të saktësojë dhe dokumentojë shkaqet e pretenduara, lidhjen e tyre me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë a të pafavorshëm, si dhe të plotësojë informacionin e dokumentacionin e nevojshëm.
- Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, nga komunikimi nëpërmjet postës elektronike, subjekti ankues, me datë 05.10.2023, ka paraqitur të njëjtat pretendime si në ankesë, si dhe ka parashtruar, ndër të tjera, si më poshtë vijon:

“ZVAP Shijak ka kryer shkelje tek procedurat e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Pas konkurimit për të dytin vit radhazi në portal, mendova se duhet të emërohesha si mësuese definitive, dhe për këtë arsye i kam kërkuar Drejtoreshës së ZVAP Shijak se përse vendi im

nuk zgjidhet vakant duke qenë se i plotëson të gjitha kushtet sipas ligjit, dhe ajo më është përgjigjur se këtë zyrë e drejtoj unë dhe e di unë se çfarë bëj.

Në vitin 2022-2023 ZVAP Shijak ka shpallur 2 vende me kontratë provizore, një nga të cilët e fitova në portal dhe në këtë shkollë orët kishin vazhdimësi dhe për vitet e tjera dhe unë mendova se do të merrja kontratë definitive, meqenëse lejen e lindjes e mora në fund të muajit nëntor 2022 dhe gjatë kohës së lejes së lindjes, vendi do të më ruhej, ndërkohë që ZVAP Shijak na bënte presion për të firmosur mbylljen e kontratës së punës. Në muajin shtator 2023 vendin që unë e kisha në vitin paraardhës 2022-2023, ZVAP Shijak e nxjerr vakant duke më vënë për të disatën herë në një pozitë të vështirë diskriminimi.

Për bindjet politike të titullarit të ZVAP Shijak nuk kam dijeni por unë këto bindje i kam lidhur me shkakun se babai i bashkëshortit tim K. H, i ndjeri A. H ka qenë i përndjekur politik dhe bashkëshorti im një ditë në ambientet e ZVAP Shijak, dëgjoi një bisedë me tone të larta tek zyra e Drejtoreshës ku u përmend disa herë fjala “Kulak-kulak-kulak”, dhe nisur nga kjo mendoj se jam diskriminuar.

Kërkesa dhe ankesa në rrugë zyrtare nuk ka paraqitur pranë ZVAP Shijak, pasi aty nuk na jepet asnjë lloj zgjidhjeje për shkak të diskriminimit që na është bërë.”

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare_ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon

ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga këqyrja e analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezulton se:

- Bazuar në shkresën me nr. 15 prot., datë 19.09.2023, të shkollës 9-vjeçare “Petrit Llaftiu”, Shijak, Xh. H ka punuar me afat të caktuar, si mësuese e lëndës “Fizikë-TIK”, për periudhën 11.12.2020 – 08.06.2021, (për rreth 6 muaj) me gjithsej 20 orë në javë, nga të cilat: 9 orë pranë shkollës “Petrit Llaftiu”, Shijak, 7 orë pranë shkollës “Isa Domi”, Pjezë dhe 4 orë pranë shkollës “Adem Sabli”, Borakë.
- Bazuar në shkresën me nr. 16 prot., datë 19.09.2023, të shkollës 9-vjeçare “Petrit Llaftiu”, Shijak, Xh. H ka punuar si mësuese e lëndës “Fizikë-TIK”, me afat të caktuar për periudhën 05.10.2021 – 24.06.2022, (për rreth 8 muaj) me gjithsej 22 orë në javë, nga të cilat: 11 orë pranë shkollës “Petrit Llaftiu”, Shijak, dhe 11 orë pranë shkollës “Lidhja e Prizrenit”, Shijak.
- Bazuar në shkresën me nr. 550 prot., datë 20.09.2023, të shkollës 9-vjeçare “Rilindja”, Sallmone, Xh. H është emëruar si mësuese e lëndës “Fizikë-TIK”, me kontratë me afat të caktuar për periudhën 26.09.2022 – 15.06.2023, Ajo ka punuar për periudhën 26.09.2022 deri më datë 30.11.2022 dhe më datë 01.12.2022 ka marrë lejen e lindjes. Marrëdhëniet e punës me Institucionin Arsimor “Rilindja” kanë përfunduar me datë 15.06.2023.
- Ankuesja aktualisht është duke kryer lejen e lindjes, e cila zgjat deri me datë 30.11.2023.
- Ankuesja ka aplikuar në portalin “Mësues për Shqipërinë”, ZVAP Shijak me datë 16.06.2023, duke u renditur e gjashta në klasifikim, me 42 pikë në total. (duke mbartur vetëm pikët e testimi të fundit)
- Ankuesja pretendon se, ZVAP Shijak e ka diskriminuar atë duke shpallur si vend vakant, (për vitin shkollor 2023-2024) vendin që ajo kishte në vitin paraardhës, pra 2022-2023, ndërkohë që ishte me leje lindje, dhe njëherësh ZVAP Shijak e ka diskriminuar atë edhe në vitet paraardhëse, pasi nuk ka bërë emërimin e saj si mësuese me kontratë me afat të pacaktuar, por e ka emëruar atë me kontratë me afat të caktuar. Ajo ka kërkuar nga Komisioneri që të hetohet dokumentacioni i portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ZVAP Shijak, për degën e Fizikës për vitet shkollore nga 2020-2021, e në vijim.

Pas analizimit sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, sa i takon pretendimit të ankueses për diskriminim nga ZVAP Shijak, për vitin shkollor 2020-2021, Komisioneri evidenton faktin se ankesa është regjistruar pranë KMD-së me datë 25.09.2023. Lidhur me pretendimin për modalitetet e kontratës së punës (afatin e caktuar) kontrata është nënshkruar me vullnet të lirë mes palëve (Shkollës/Punëdhënësit dhe Mësuesit/ankueses) dhe ankuesja në momentin e nënshkrimit të saj (dhjetor 2020) ka marrë dijëni dhe është dakordësuar lidhur me afatin për të cilin është punësuar/emëruar si mësuese pranë shkollës “Petrit Llaftiu”, Shijak, me afat të caktuar. Ndërsa ankesën pranë KMD-së e ka paraqitur më datë 25.09.2023.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetases Xh. H, lidhur me pretendimet për veprime a mosveprime të ndodhura gjatë vitit shkollor 2020-2021, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj, pasi është paraqitur më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sa ka pretenduar.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Kur një e drejtë (e drejta për t’ju drejtuar Komisionerit) nuk ushtrohet në afatin e caktuar ligjor, atëherë individi ka humbur të drejtën që pretendimet e tij të shqyrtohen në themel nga Komisioneri, kjo edhe në respektim të parimit të sigurisë juridike.

Së dyti, lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim nga ana e ZVAP Shijak, lidhur me emërimin e saj si mësuese me kontratë me afat të caktuar për vitin shkollor 2021-2022, Komisioneri vëren se:

Subjekti ankues ka cituar që është diskriminuar nga ana e ZVAP Shijak, për vitin shkollor 2021-2022, duke referuar si shkaqe të pretenduara diskriminimi:

- Duke cilësuar faktin se vjehri i saj i ndjerë kishte qenë i persekutuar (ish-dënuar) nga regjimi komunist, pa dhënë asnjë shpjegim, apo sqaruar rrethana me fakte e prova se si ajo është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e ZVAP Shijak, apo se si ky trajtim lidhet me këtë shkak të pretenduar prej saj.
- Shtazëninë, duke referuar e dokumentuar barrë lindjen e saj.

Për sa më sipër, shkak i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit, si dhe duhet vërtetuar me prova të mbështetura në fakte konkrete.

Lidhur me provueshmërinë e këtyre dy shkaqeve të pretenduar, për sa i takon periudhës kohore konkrete, vitit shkollor: shtator 2021- qershor 2022, Komisioneri vlerëson se ato nuk rezultojnë të provuara, në kontekst të shkakut të kërkuar sipas LMD-së.

Kështu në kronologji kohore:

- Referuar Raportit për Leje Barrëindje, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Xhafzotaj, më datë 01.12.2022, ankueses Xh. H i jepet pushim (paralindje) duke filluar prej datës 01.12.2022 deri më datë 05.01.2023.
- Në momentin që ankueses i ka përfunduar kontrata e punës (me afat të caktuar) me datë 24.06.2022, ajo nuk ka qenë raport barrëindje, pasi atë e ka filluar 6 (gjashtë) muaj më vonë, me datë 01.12.2022.

Pra, në momentin e përfundimit të kontratës ajo nuk ka poseduar shkakun e pretenduar, të cilin e mbart në vitin shkollor pasardhës, për rrjedhojë edhe pretendimet bazuar në këtë shkak nuk qëndrojnë dhe nuk rezultojnë të provuara.

Ndërsa, lidhur me provueshmërinë e shkakut të dytë të pretenduar, atë të faktit që vjehri i saj i ndjerë ka qenë ish-i dënuar dhe i persekutuar nga ish-regjimi komunist në Shqipëri, ky shkak rezulton i dokumentuar:

- Bazuar në Certifikatën familjare të Zyrës së Gjendjes Civile nr. 83, rezulton që K. H, është i biri i A. H.
- Sipas shkresës me nr. 448 prot., datë 03.11.2022 “Vërtetim për dhënie statusi”, të Institutit të Integritit ish-të Përndjekurve Politikë, A. H i jepet e Drejta e Statusit të ish-të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë.

Subjekti ankues në rastin në fjalë ka paraqitur dokumentacionin për të vërtetuar në vetvete shkakun e pretenduar, por, pavarësisht këtij fakti, Komisioneri vlerëson se, ankuesja nuk ka dhënë asnjë shpjegim të arsyeshëm, apo sqaruar rrethana me fakte e prova se si ajo është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e ZVAP Shijak, apo se si ky trajtim lidhet me këtë shkak, apo se si ZVAP Shijak ishte në dijeni se ajo posedonte shkakun e pretenduar.

Shpjegimi i vetëm i dhënë nga ankuesja, i referohet një momenti, kur bashkëshorti i saj, i ndodhur rastësisht pranë Zyrës së titullares së ZVAP Shijak ka dëgjuar atë të thotë me zë të lartë, fjalën “kulak”, dhe nisur nga kjo ka hamendësuar se mund ta ketë paragjykuar ankuesen për shkak të statusit të vjehrit të saj të ndjerë. Njëherësh, Komisioneri mban në konsideratë edhe faktin që, nga ana e ankueses nuk është saktësuar momenti se kur pretendohet të ketë ndodhur kjo situatë, (pavarësisht se janë deklarime verbale të saj), thjesht citohet se gjatë vitit 2022 (pa cilësuar nëse bëhet fjalë për vitin shkollor 2021-2022 apo 2022-2023).

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkakun sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këtë shkak, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte e prova mbi të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Pala ankuese nuk parashtroi fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur një diferencë në trajtimin ndaj saj nga ana e ZVAP Shijak, që të jetë motivuar nga statusi i ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politik, që ka poseduar vjehri i saj i ndjerë.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tyre i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat, lidhur me emërimin e saj me kontrata me afat të caktuar.

Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, apo të mos parashtrimit të fakteve mbi të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim e se kjo diferencë bazohet në shkakun/shkaqet e pretenduar/a; nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga ankuesja lidhen pikërisht me këtë “shkak” apo këto “shkaqe”.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Neni 1, i këtij Ligji, është në të njëjtën linjë me parashikimet e nenit 14, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së).

Gjatë shqyrtimit të çështjeve me pretendim diskriminim bazuar në shkaqet e parashikuara në LMD, Komisioneri, gjithashtu, i referohet edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës, si dhe me shkaqet e parashikuara në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

Referuar sa më lart, ankuesja nuk solli asnjë provë që të dokumentonte shkaqet e pretenduara prej saj, si dhe nuk solli prova e fakte mbi të cilat mund të prezumohej se diferenca në trajtim i ka ardhur për shkaqet e pretenduara.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Së treti, lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim nga ana e ZVAP Shijak, për vitin shkollor 2023-2024, lidhur me faktin se kishte shpallur vakant pozicionin e punës që ajo mbante gjatë vitit 2022-2023 në shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, Sallmone, ndërkohë që në këtë vend ishte ankuesja, Komisioneri vëren se:

- Bazuar në shkresën me nr. 550 prot., datë 20.09.2023, të shkollës 9-vjeçare “Rilindja”, Sallmone, Xh. H është emëruar si mësuese e lëndës “Fizikë-TIK”, me kontratë me afat të caktuar për periudhën 26.09.2022 – 15.06.2023.
- Ajo ka punuar për periudhën 26.09.2022 deri më datë 30.11.2022 dhe më datë 01.12.2022 ka marrë lejen e lindjes.
- Marrëdhëniet e punës me Institucionin Arsimor “Rilindja” kanë përfunduar me datë 15.06.2023.
- Ankuesja aktualisht është duke kryer lejen e lindjes, e cila zgjat deri me datë 30.11.2023.
- Ankuesja ka aplikuar në portalin “Mësues për Shqipërinë”, ZVAP Shijak me datë 16.06.2023, duke u renditur e gjashta në klasifikim, me 42 pikë në total. (duke mbartur vetëm pikët e testimit të fundit)

Bazuar në sa më lart, Komisioneri konstaton se, subjekti ankues ka qenë më marrëdhënie pune me shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, Sallmone, marrëdhënie e formalizuar me një kontratë pune me afat të caktuar, për periudhën 26.09.2022 – 15.06.2023.

Për rrjedhojë përfundimi i marrëdhënieve të punës ka ardhur si rezultat i përfundimit të afatit të përcaktuar shprehimisht në kontratën e punës (kontratë me afat të caktuar), kontratë e cila përfundon automatikisht për shkak të afatit.

Sipas nenit 149⁵, të Kodit të Punës, kjo kontratë ka përfunduar në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake. Pra, nuk jemi në kushtet e parashikuara nga neni 147, i Kodit të Punës, që parashikon zgjidhjen e kontratës së punës në kohë të papërshtatshme, pasi

⁵“1. Kontrata me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake.”

kjo dispozitë lidhet vetëm me kontratat me afat të pacaktuar. Ajo bën pjesë në grupin e dispozitave nga neni 141-148, i Kodit të Punës, që aplikohen për kontratat e punës me afat të pacaktuar.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses se ZVAP Shijak ka shpallur vakant për vitin shkollor 2023-2024, pozicionin e saj të punës që ajo mbante, gjatë vitit 2022-2023 (për shkak se ishte me raport leje lindje dhe ajo vijonte të ishte e emëruar në këtë pozicion pune), është haptazi i pabazuar dhe i pa mbështetur e i padokumentuar në asnjë provë.

Kontrata e punës së ankueses për pozicionin e punës që ajo mbante për vitin 2022-2023, sipas arsytimit të mësipërm, ka qenë me afat të caktuar dhe ka mbaruar automatikisht me përfundimin e afatit të caktuar, pra me datë 15.06.2023.

Në këto kushte, fakti që ankuesja gëzon lejen e lindjes, të pagueshme deri në muajin nëntor 2023, leje e cila paguhet nga Sigurimet Shoqërore dhe jo punëdhënësi, nuk do të thotë që ajo është në marrëdhënie pune me shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, Sallmone edhe për këtë vit shkollor 2023-2024, pasi kontata e punës mes tyre ka përfunduar me datë 15.06.2023.

Detyrimisht vendi që ankuesja ka mbajtur në këtë shkollë, gjatë vitit shkollor 2022-2023, sipas kontratës respektive ka qenë i përcaktuar deri në 15.06.2023 dhe në vijim do të mbulohej nga një mësues/e tjetër, sipas përcaktimeve e modaliteteve të kontratës që do të lidhej për vitin shkollor 2023-2024. Pra, shpallja “vakant” për vendin e punës që ajo mbante gjatë vitit 2022-2023, është bazuar në qënien e këtij vendi vakant e të pambuluar nga ndonjë mësues tjetër, për vitin shkollor 2023-2024. Për rrjedhojë pretendimi se ky vend ishte “i saj” dhe nuk mund të shpallej vakant është tërësisht i pabazuar dhe i pambështetur në prova e fakte.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “ç”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga pala ankuese kundër ZVAP Shijak, nuk mund të pranohet, pasi është haptazi e pabazuar dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç/dh, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues Xh. H, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA